

LIGJ

74/2019, datë 05.12.2019

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË 2.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, ‘PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 2.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’”, të ndryshuar.

KRYETAR**Gramoz Ruçi**

Miruar në datën 4.11.2019

Botuar ne Fletoren Zyrtare 162/2019, datë 02.12.2019

AKT NORMATIV**Nr. 3, datë 02.10.2019****PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas pikës 8, të nenit 27, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet

që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1 Dispozitë tranzitore Personat që aplikojnë për t’u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e tërmetit të datës 21 shtator 2019, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar ne Fletoren Zyrtare 137/2019, datë 07.10.2019

LIGJ**78/2019, datë 05.12.2019****PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT NR. 4, DATË 30.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014 ‘PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.

KRYETAR**Gramoz Ruçi**

Miratur në datën 05.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11383, datë 12.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Botuar ne Fletoren Zyrtare 171/2019, datë 16.12.2019

AKT NORMATIV**Nr. 4, datë 30.11.2019****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 56, “Përjashtime të veçanta në import”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm: 1. Në fund të pikës 28 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje: “... përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar.”. 2. Pas pikës 42 shtohet pika 43, me këtë përmbajtje: “43. Mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.”.

Neni 2

Fjalja e dytë, e pikës 2, të nenit 77, shfuqizohet.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar ne Fletoren Zyrtare 161/2019, datë 30.11.2019

LIGJ**79/2019 date 05.12.2019****PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË 30.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, ‘PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar.

KRYETAR**Gramoz Ruçi**

Miruar në datën 05.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11384, datë 12.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Botuar ne Fletoren Zyrtare 171/2019 Datë 16.12.2019

AKT NORMATIV**Nr. 5, datë 30.11.2019****PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Në fund të pikës 1, të nenit 21, “Shpenzime të panjohura”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar, shtohet shkronja “p”, me këtë përmbajtje: “p) Donacionet në mjete monetare mbi nivelin 5% të fitimit para tatimit, të bëra për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar, dhe të transferuara në llogaritë e thesarit. Në rastet kur donacionet për shkak të

shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” janë në formën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i kontributit deri në nivelin 5%, në raport me fitimin para tatimit llogaritet sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar ne Fletoren Zyrtare 162/2019, datë 02.12.2019

LIGJ**81/2019, datë 05.12.2019****PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË 30.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993, ‘PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar.

KRYETAR

Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 05.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11385, datë 12.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Botuar ne Fletoren Zyrtare 171/2019, datë 16.12.2019

AKT NORMATIV**Nr. 7, datë 30.11.2019****PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas nenit 5/1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shtohet neni 5/1/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1/a Trajtim i veçantë financiar Pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes si pasojë e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, përfitojnë trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social, ndërsa personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë deri në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social. Pensionistët, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë vetëm trajtimin në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social. Trajtimi i veçantë financiar caktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar ne Fletoren Zyrtare 162/2019, datë 02.12.2019

VENDIM**Nr. 142, datë 13.2.2020****PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 651, DATË 10.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 102/2014, ‘KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 188, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 479, të vendimit nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në fillim të paragrafit bëhet numërtimi, duke filluar nga numri 1.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Në ndryshim sa parashikohet në pikën 1, përjashtohen nga detyrimet e importit materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara për këtë qëllim nga organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike, për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, brenda programit të rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit për rindërtimin.

Materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara përjashtohen sipas zërave dhe sasive të parashikuara në preventivin e miratuar nga njësia zbatuese ose nga organi kompetent përkatës, sipas legjislacionit për rindërtimin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM**Nr. 143, datë 13.2.2020****PËR PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT, PËR SUBJEKTET E RINDËRTIMIT DHE PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË FURNIZIMIT TË MALLRAVE E SHËRBIMEVE, PËR QËLLIME TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53, shkronjat “P” e “L”, dhe 56, pika 28, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:**Neni 1**

Përfashtimi nga TVSH-ja i furnizimit të procesit të ndërtimit, i kryer nga subjekte të autorizuar të rindërtimit, dhe i furnizimit të mallrave e shërbimeve që përdoren prej tyre vetëm për qëllime të rindërtimit

Bazuar në nenet 53, shkronjat “P” e “L”, dhe 56, pika 1, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfashtohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), brenda programit dhe përgjatë periudhës së rindërtimit për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, sipas përcaktimeve në legjislacionin e rindërtimit:

- a) furnizimi i procesit të ndërtimit, që realizohet nga ndërtuesit, subjekte të rindërtimit;
- b) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave për procesin e ndërtimit, i kryer direkt për ndërtuesit, subjekte të rindërtimit;
- c) importimi i mallrave për procesin e ndërtimit, i kryer direkt nga ndërtuesit, subjekte të rindërtimit.

Neni 2

Procesi i rindërtimit dhe programet e tij, për të cilat zbatohen përfashtimet nga TVSH-ja

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 97/2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përfashtimi nga TVSH-ja janë:

- a) Programi i ndërtimit të objekteve në zonat e reja apo në të njëjtin truall, që përfshin:
 - i. ndërtimin e objekteve të reja dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;
 - ii. ndërtimin e objekteve të reja dhe të infrastrukturës publike nga donatorët;
 - iii. rindërtimin e ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall.
- b) Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike, kur nuk është pjesë e programeve të tjera të parashikuara në ligj, dhe të infrastrukturës kritike, me anë të të cilit, me financim nga fondi i rindërtimit apo nga donatorët, ndërtohen ose rikonstruktohen objekte të infrastrukturës publike dhe kritike nga njësitë zbatuese.

Neni 3

Subjektet e rindërtimit të autorizuara për përjashtimin nga TVSH-ja

Përjashtohen nga TVSH-ja:

- a) ndërtuesit/kontraktorët, subjekte të rindërtimit, të cilët u nënshtrohen dispozitave të ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimeve të këtij vendimi;
- b) ndërtuesit/kontraktorët, subjekte të rindërtimit, të cilët duhet të kenë lidhur një marrëveshje kuadër me njësinë zbatuese, të ngarkuar nga Këshilli i Ministrave për administrimin e fondeve të shpërndara nga fondi i rindërtimit dhe që përdoren bazuar në procedurat e ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, në lidhje me prokurimin publik për rindërtimin;
- c) ndërtuesit/kontraktorët, subjekte të rindërtimit, të përcaktuar nga donatorët, për rastet kur donacionet/grandet e tyre nuk janë pjesë e fondit të rindërtimit sipas ligjit të buxhetit.

Neni 4

Procedura për lëshimin e autorizimit për ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, dhe mënyra e zbatimit të përjashtimit

Për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të mësipërme, ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, duhet të jenë të autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, për t'u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëngjitet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;
- b) marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës;
- c) marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit, në rastet kur ndërtuesi, subjekt i rindërtimit, është përcaktuar nga donatori që ka marrë përsipër procesin e ndërtimit, në përputhje me programin e rindërtimit; ç) preventivin e punimeve, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur fitues për kontratat publike për punime/shërbime ndërtimi në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, shoqëruar kjo me listën e detajuar të materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit;
- d) kopjen e lejes së ndërtimit, të miratuar nga organet kompetente.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda pesë ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga ndërtuesi, subjekt i rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesë ditor.

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda pesë ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, lëshon autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja për ndërtuesin, subjekt të rindërtimit.

Një kopje e autorizimit, së bashku me preventivin e punimeve, sipas zërave dhe sasive që do të përdoren në procesin e ndërtimit, i përcillet drejtorisë rajonale tatimore përkatëse, që ka në administrim tatimpaguesin, ndërtues, subjekt të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen zyrtare dhe mban të përditësuar listën e ndërtuesve, subjekte të rindërtimit, të cilët janë pajisur me autorizim përjashtimi nga TVSH-ja, ku pasqyrohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit, NIPT/NUIS-i, numri dhe data e lëshimit të autorizimit.

Furnizuesit e mallrave/shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja për procesin e ndërtimit, të cilët furnizojnë direkt ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, në momentin e lëshimit të faturës tatimore duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar, si dhe numrin e datën e autorizimit të përjashtimit të ndërtuesit, subjekt të rindërtimit. Gjithashtu, furnizuesi i bashkëlidh kopjes së faturës tatimore, që mban vetë, edhe një kopje të autorizimit të përjashtimit.

Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, të cilët i importojnë vetë mallrat që do të përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit, pas marrjes së autorizimit të përjashtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, paraqiten pranë autoritetit doganor për të përfituar përjashtimin në import për këto mallra.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton procedurë/manual të posaçëm, me qëllim kontrollin e zbatimit të përjashtimeve, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni 5

Përjashtimi nga TVSH-ja në import i materialeve, pajisjeve, ndërtesave të parafabrikuara, të importuara nga organe shtetërore, organizata bamirëse dhe filantropike

Bazuar në pikën 28, të nenit 56, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, përjashtohen nga TVSH-ja në import materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara nga organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike për rindërtimin e zonave të fatkeqësive, në rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, brenda programit të rindërtimit.

Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike, që do të importojnë, pajisen me autorizim nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, këto organe/organizata duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD):

- kërkesën me shkrim, ku të jetë evidentuar NIPT/NUIS;
- dokumentin e lëshuar nga njësi zbatuese ose nga organi kompetent përkatës, sipas legjislacionit për rindërtimin, ku provohet/vërtetohet se materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, sipas zërave dhe sasive përkatëse, janë të destinuara për rindërtimin e zonave të fatkeqësive, për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, brenda programit të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda pesë ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton aplikimin për përjashtim. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati

pesëditor. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtim, i cili regjistrohet në sistemin e saj informatik.

Neni 6

Organet zbatuese

Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM**Nr. 144, datë 13.2.2020**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 132, DATË 7.3.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR METODOLOGJINË PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME ‘NDËRTEA’, E BAZËS SË TAKSËS PËR KATEGORI SPECIFIKE, NATYRËN DHE PRIORITETIN E INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË TAKSËS, SI DHE TË KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN ALTERNATIV TË DETYRIMIT TË TAKSËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 22/1, 22/3 e 22/4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “c” dhe “ç”, të aneksit 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen si më poshtë vijon:

“c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijtur ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**

VENDIM**Nr. 145, datë 13.2.2020****PËR KUSHTET, RREGULLAT DHE DOKUMENTET QË SHOQËROJNË KËRKESËN PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR RINDËRTIMIN, RIPARIMIN APO RESTAURIMIN E NDËRTIMEVE TË DESTINUARA PËR QËLLIME BANIMI, TË DËMTUARA SI PASOJË E FATKEQËSISË NATYRORE, PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e kushteve, rregullave dhe dokumenteve që shoqërojnë kërkesën për dhënie e lejes së ndërtimit për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, për përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

2. Për të përfutur përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas pikës 9, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, për investimet që shërbejnë për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, së bashku me dokumentacionin përkatës që shoqëron kërkesën për dhënie e lejes së ndërtimit, investitori duhet të paraqesë edhe dokumentet, si më poshtë vijon:

a) aktin që vërteton dëmtimin e ndërtesës për shkak të fatkeqësisë natyrore;

b) dokumentin që përcakton shkallën e dëmtimit të ndërtesës, vlerën në lekë të dëmtimit, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe nivelin e ndërhyrjes që nevojitet në ndërtesën e dëmtuar.

Dokumentet e mësipërme lëshohen nga autoriteti përkatës, të përcaktuara sipas procedurave të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”, që bëjnë vlerësimin e dëmeve në rastin e fatkeqësisë natyrore.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore verifikojnë dokumentet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, dhe, në rast të plotësimit të tyre, aplikojnë përjashtimin nga taksë e ndikimit në infrastrukturë, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**